



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ae.nr 1/2019**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegji, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses [“B.”] sh.p.k., me seli në ..., kundër të paditurës “Posta dhe Telekom i Kosovës” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike V.Ek.nr.159/17, të datës 07.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.02.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditëses [“B.”] sh.p.k., me seli në ..., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.Ek.nr.159/17, të datës 07.11.2018, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses [“B.”] sh.p.k., me seli në ... për shkak të mospjesëmarrjes në seancën e datës 07.11.2018.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë paditësit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe shkeljes esenciale të dispozitave ligjore duke propozuar që Gjykata e Apelit aktvendimin e atakuar V.Ek.nr.159/17, të datës 07.11.2018 ta anulojë dhe lënda të kthehet në rivendosje në shkallën e parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së , gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësit [“B.”] sh.p.k., me seli në ..., ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurës “Posta dhe Telekom i Kosovës” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje ka caktuar seancën kryesore me datë 07.11.2018, në të cilën pala paditëse nuk është paraqitur në seancë dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e saj përkundër ftesës së dërguar dhe të pranuar me rregull, e cila gjendet në shkresat e lëndës. Andaj, gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të tërhequr padinë dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi pretendimet ankimore të paditësit, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, por gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, respektivisht nenin nenin 423 paragrafi 3 të LPK-së me të cilin përcaktohet se “ *Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, për veçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesore i çështjes në mungese të paditësit*”

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi e ka pranuar ftesën për seancën e datës 07.11.2018, në mënyrë të rregull, dhe mospjesëmarrjen e ka arsyetuar se, nuk kemi qenë në dijeni për caktimin e seancës për këtë çështje juridike dhe për këtë nuk kemi marr pjesë, përndryshe ne kemi qen të interesuar për këtë lëndë, si dhe ftesën për pjesëmarrje në seancën nuk e kemi marr, andaj edhe nuk kemi pas dijeni për caktimin e seancës.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e paditësit nuk përbëjnë arsye ligjore për të cilat duhet prishur aktvendimi i atakuar, sepse pranimi i ftesës nga paditësi është bërë në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa përfaqësuesi i të paditurës nuk ka kërkuar që seanca të mbahet por ka kërkuar që padia të konsiderohet e tërhequr.

Nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë lëshim i gjykatës së shkallës së parë sepse pala paditëse edhe pse është ftuara në mënyrë të rregullt, sepse dita dhe ora e mbajtjes së seancës i është komunikuar në rregull, që vërtetohet edhe nga nënshkrimi në fletkthesë i personit të autorizuar për pranimin e ftesave. Për më tepër paditësit kanë mundur që brenda afateve ligjore të parashtrajnë pranë gjykatës së shkallës së parë kërkesë për kthim ne gjendje të mëparshme,

por të njëjtën nuk e kanë bërë. Ndërsa konstatohet se paditësit është arsyetuar së nuk kemi qenë në dijeni për caktimin e seancës, dhe nuk kanë dhënë asnjë arsye të vetme për shtyrjen e seancës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të paditësit lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktvendimit dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse se janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 423.3, për konsiderimin e padisë të tërhequr.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 209 par.1.nën par. b), e lidhur me nenin 208 të LPK-së .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ae.nr.1/2019,dt. 21.02.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli, d.v**

